

Komuna e Suharekës 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

Suhareka udhëhiqet nga Sali Asllanaj i cili përfaqëson Lidhjen Demokratike të Kosovës. Ky është mandati i tij i dytë.

Në zgjedhjet e fundit për kryetar të komunës (nëntor 2013), Asllanaj ka fituar në balotazh kundrejt kandidatit nga Aleanca e Ardhmërisë së Kosovës, Bali Muharremaj. Ky i fundit në raundin e parë ka siguruar 9,248 vota (apo 30,66), ndërsa Asllanaj ka pasur 10,431 vota (apo 34,58%). Në balotazh Asllanaj ka siguruar të votave 54% të vota për ta qeverisë komunën.¹

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetar kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.² Mbi 88% e qytetarëve të Suharekës besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga problemet me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.³ Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Suharekës me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rënie të vogël të kënaqshmërisë nga 24.20 pikë në vitin 2012 në 23.62 në vitin 2015.⁴

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Suharekës. Ndër problemet më

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 20 qershor 2017)

² Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

³ UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 20 qershor 2017)

⁴ Ibid. faqe 39

madhore kishin dalë të jenë: mungesa e ujësjellësit dhe ujit të pijes, mungesa e ndriçimit publik, gjendja jo e mirë e objekteve shkollore, prerja e pyjeve, ndotja e lumit "Toplluha".⁵

Problemet aktuale në Komunën e Suharekës

Mungesa e ujësjellësit dhe ujit të pijes. Problem për fshatrat e Suharekës është mungesa e ujësjellësit. Fshatarët janë të detyruar t'i përmbushin nevojat e tyre me hapjen e puseve, por që gjatë verës edhe ato shterohen dhe kështu ata përballen me mungesë të ujit të pijshëm. Përveç mungesës së rrjetit të ujësjellësit në fshatra, Suhareka vazhdon të përballlet me reduktime të shpeshta të ujit të pijes në qytet. Kjo mungesë po ndikon edhe në institucione publike si në shkolla, qendra klinike të mjekësisë familjare si dhe në vetë objektin e komunës.

Mungesa e ndriçimit publik. Aktualisht vetëm disa rrugë në qendër të Suharekës kanë sistem të ndriçimit publik. Ndërsa rrugët periferike në qytet por edhe në fshatra janë pa ndriçim publik. Në disa vende ekzistojnë llambat elektrike por nuk funksionojnë. Edhe lokalitetet tjera në rajonin e Suharekës janë pa ndriçim publik madje edhe në afërsi të institucioneve publike si në afërsi të shkollave dhe ambulancave.

Prerja e pyjeve. Dukuria e prerjes së pyjeve është e shprehur në masë të madhe në këtë komunë, e në veçanti në zonat e thella. Pyjet e fshatit Delloc dhe ato në Bjeshkën e Mushtishtit gjithnjë e më tepër po shkatërrohen duke u prerë ilegalisht.

Ndotja e lumit "Toplluha". Lumi i qytetit "Toplluha" është problem që e ka përcjellë në vazhdimësi qytetin e Suharekës. Shumë fshatra përreth dhe zonat e qytetit bëjnë derdhjen e kanalizimeve në këtë lum duke ndotur shtratin e lumit dhe duke shkaktuar edhe kundërmime, veçmas gjatë zonës së verës.

Mungesa e trotuareve. Në raportin e fundit të Ministrisë e Administratës të Pushtetit Lokal 2016 del se vetëm 16.30% e territorit të Komunës së Suharekës janë të ndërtuara trotuaret për këmbësorë.⁶


⁵<http://www.komunat.institutigap.org/> Instituti GAP Raporti komunal. Komuna e Suharekës.2013 fq.2

⁶ Ministria e Administratës e Pushtetit Lokal/Raporti i Performances 2016. Burimi: <http://bit.ly/2t297r8>

Trendet buxhetore në Komunën e Suharekës (2017)

Komuna e Suharekës në vitin 2017 ka planifikuar 13.8 milion euro buxhet.⁷ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe 842 mijë euro të tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara.⁸ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013^{*9}, që ishte vit i zgjedhjeve lokale, Komuna e Suharekës ka pasur një rritje prej 1.5 milionë euro të buxhetit. Kjo rritje në masë të madhe buron nga rritja e granteve qeveritare.

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Suharekës 2017



Në buxhetin e vitit 2017 janë ndarë rreth dy milionë euro më shumë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve (8 milionë euro) se në 2013, ndërsa janë reduktuar investimet kapitale (4.1 milionë euro) për mbi 800 mijë euro. Po ashtu kategoria e subvencioneve dhe transfereve është rritur në mënyrë të theksuar (73%), por ajo ende zë një pjesë shumë të vogël në buxhetin vjetor (2%). Ndikim të madh në rritjen e buxhetit për paga kishte vendimi i Qeverisë së Kosovës i vitit 2014 për rritjen e pagave në

⁷ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD> dhe Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.


⁸ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63 (hapur më 6 shtator 2017).

* Në këtë vit mjetet e bartura nga të hyrat e pashpenzuara ishin më të mëdha se në 2017 për rreth 550 mijë euro. Shih Raportin vjetor financiar 2012. Ministria e Financave. Burimi: <http://bit.ly/2wKArJf>, faqe 60 (hapur më 6 shtator 2017).

⁹ Shih Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

sektorin publik për 25%.¹⁰ Gjithashtu, angazhimi i 22 punonjësve të rinj në periudhën 2013-2016 ka bërë që shpenzimet për paga të rrisin pjesëmarrjen e tyre në buxhetin vjetor të komunës. Për më shumë, gjatë vitit 2016 Suhareka kishte të punësuar edhe 32 punonjës me kontratë mbi vepër.¹¹

Figura nr.2: Trendet buxhetore të Suharekës më 2013 dhe 2017



Të hyrat vetanake të Komunës së Suharekës kanë pasur ngritje dhe rënie të lehta përgjatë katër viteve të fundit. Mirëpo, Komuna e Suharekës ka mbajtur një mesatare të qëndrueshme të hyrash komunale. Gjatë vitit 2016 janë realizuar si të hyra vetanake 1.78 milionë euro, rënie kjo e lehtë në krahasim me vitin 2015 kur janë shënuar rreth 1.81 milionë euro të hyra.¹² Tatimi në pronë mbetet kategoria që kontribuon më së shumti në të hyrat komunale, specifikisht me 696 mijë euro (rreth 39%). Ndërsa kategoria me arkëtim më të vogël të të hyrave, rreth 120 mijë euro më pak se në 2015, ishte ajo e taksave administrative dhe kadastrës.¹³


¹⁰ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M> (hapur më 6 shtator 2017).

¹¹ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj> (hapur më 6 shtator 2017).

¹² Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Suharekës 2016. Burimi: <http://bit.ly/2xh7uYA> (hapur më 6 shtator 2017).

¹³ Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2016 për Komunën e Suharekës.

Figura nr.3: Të hyrat komunale të Suharekës, 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të përgjithshëm

Sipas vlerësimeve buxhetore të prezantuara në ligjin për buxhetin 2017¹⁴, buxheti i Suharekës nuk do të ketë rritje të madhe më 2018 dhe 2019. Krahasuar më 2017, në këto dy vite të ardhshme buxheti planifikohet të jetë rreth dy përqind (14.1 milionë euro) dhe katër përqind (14.4 milionë euro) më i lartë, respektivisht. Shpërndarja e buxhetit të rritur planifikohet të bëhet në mënyrë të barabartë në shumicën e kategorive me përjashtim të asaj të rinisë dhe kulturës të cilës planifikohet ti dyfishohet buxheti në 2019.

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna duhet të zgjerojë rrjetin e ujësjellësit në gjitha vendbanimet ku aktualisht ky rrjet mungon.
- Komuna duhet të gjej burime të reja të ujit me qëllim të furnizimit të qytetarëve me ujë të pijes, reduktimet ndaj të cilëve janë të gjata dhe të shpeshta.
- Komuna duhet t'i rris zonat të cilat i mbulon me ndriçim publik.
- Komuna duhet të gjej fonde për t'i trajtuar ujërat e zeza në qytet.
- Komuna duhet të gjej mënyra për të ndalur hedhjen e mbeturinave në lumin e qytetit.

¹⁴ Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, faqe 226.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

